

VENDIM
Nr.1473, datë 12.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË
NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË
KRYERA NGA SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Shërbimit Informativ të Shtetit t’i përfundojë, deri në datën 20 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1

Nr.	Objekti i prokurimit	Lloji i procedurës
1	Blerje karburanti për (auto, ngrohje dhe ndriçim)	Me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
2	Blerje pjesë këmbimi për automjete	E hapur
3	Blerje pajisjesh elektroshtëpiake	Kërkesë për propozim
4	Blerje pajisjesh hoteli mobilierie	Kërkesë për propozim
5	Blerje materialesh për funksionimin e pajisjeve speciale (blerje bateri për radio dore dhe UPS)	Kërkesë për propozim
6	Rikonstrukcion tarrace, zyra dhe kanalizimeve ujërash të bardha.	Kërkesë për propozim